



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.32, datë 26.06.2007

PËR

MIRATIMIN NË PARIM TË FINANCIMIT TË PROJEKTIT “NDËRTIMI I BANESAVE SOCIALE ME QIRA”, NË QYTETIN E TIRANËS, NËPËRMJET HUASË ME QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS.

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 10, pika 3/l, gërma “g”, neni 6, pika 5, neni 32, gërma “dh”, ligjit Nr.9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, me ndryshime, ligjit Nr.8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me ndryshime, neni 6, pika 6.5, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë në parim financimin e projektit “**Ndërtimi i banesave sociale me qira**” në qytetin e Tiranës, në masën 60% me huanë që do të merret nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, financuar nga Marrëveshja Kuadër e Kredisë me Bankën e Këshillit të Europës (C.E.B) mbas ratifikimit të saj dhe 40% me kontribut (në para dhe në natyrë) Buxhetin e Bashkisë së Tiranës.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, të bëhet shlyerja vetëm e detyrimit të huasë, pa interesa dhe T.V.SH-në, kontribute këto të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, sipas marrëveshjes Kuadër të Kredisë me Bankën e Këshillit të Europës (C.E.B)
3. Afatet dhe mënyra e pagesës së huasë të jenë ato të përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë (draft), bazuar në termat e Marrëveshjes Kuadër të Kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (C.E.B).
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë së Tiranës, për të negociuar termat teknike dhe financiare, si dhe për të nënshkruar Marrëveshjen e Huasë me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave.
5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës.
6. Ky Vendim, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R